

UDHËZIM
Nr. 18, datë 30.8.2016

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, të ndryshuar, bëhet 11.510 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.
 2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2016 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
 3. Udhëzimi nr. 24, datë 20.8.2015, i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.
- Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2016.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi